

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 47, deri më 23.11.2025)

TË DHËNA JAVORE

Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë javës së 47 të vitit 2025 (nga 17-23.11.2025), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 91 raste ($I=5,0/100.000$ banorë) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 22,2% më pak se javën që shkoi (117). Në javën e 47 të vitit të kaluar janë regjistruar 63 të sëmurë (rritje për 44,4%), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (89) është regjistruar një rritje prej 2,2%.

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në Gostivar – 35, Tetovë – 13, Shtip dhe Strumicë – nga 11, ndërsa në Kumanovë, Prilep, Shkup, Kavadar, Radovish, Negotinë dhe Sveti Nikole janë regjistruar më pak se 10 raste.

Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 71 të sëmurë, ndërsa tek grupmosha mbi 65 vjet – 13, tek grupmosha 5-14 vjet - 7 dhe tek grupmosha 0-4 vjet nuk janë regjistruar të sëmurë.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit ($I=22,03/100.000$) është nën prapun sezonal, gjegjësisht ende nuk është arritur pragu i hyrjes në sezonin e gripit.

Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së 47 të raportimit pranë pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 26 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV. Nga materialet e testuara 2 kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit - Influenza A(H1)pdm09.

Është regjistruar një rast pozitiv me SARS-CoV-2.

Nuk janë regjistruar raste pozitive me RSV.

TË DHËNA KUMULATIVE

Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë sezonit 2025/2026 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin është **662** ($I=36,0/100.000$).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar ($n=389$) numri i rasteve të raportuara është rritur për 70,2%, ndërsa krahasuar me modelin për 15 vitet e fundit ($n=505$) është regjistruar një rritje prej 31,1%.

Të sëmurë janë regjistruar në gjithsej 15 QShP/NjR. Numri më i madh i të sëmurëve dhe incidencë më e lartë kumulative ($n=230$; $I=271,7/100.000$) është regjistruar në Gostivar.

Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numri më i madh i të sëmurëve bëjnë pjesë në grupmoshën që përfshin numrin më të madh të popullatës (nga 15-64 vjet) – 508 raste (76,7%).

Mbikëqyrja virologjike

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 197 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Nga numri i përgjithshëm i materialeve të analizuar janë zbuluar dy raste pozitive të gripit - Influenza A(H1)pdm09. Janë regjistruar 5 rezultate pozitive për SARS-CoV-2 dhe dy pozitive për RSV.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi: <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtje nga gripin kanë për qëllim parandalimin e të gjitha sëmundjeve akute të frymëmarrjes dhe mund të jenë shumë të dobishme, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Evitoni grumbullimin dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, sidomos kontaktin e ngushtë me njerëz që janë të sëmurë ose që kolliten, teshtijnë, kanë temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose me dezinfektues.
- Ngrohni dhomat në të cilat qëndroni dhe ajrosini ato shpesh.
- Këshillohet të vishni rroba të ngrohta, në disa shtresa, të bëni banjo të ngrohta.
- Pini pije të nxehta (çajra dhe supa), lëngje frutash, ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira e të nevojshme për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limona, portokalle) janë veçanërisht të dobishme. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë të disponueshme, mund të përdoren edhe pije dhe preparate multivitaminike.
- Praktikoni një stil jetese dhe zakone të shëndetshme, duke përfshirë këtu gjumin dhe pushimin e mirë, të ushqyerit e shëndetshëm, ruajtjen e aktivitetit fizik dhe mendor dhe uljen e stresit.

Sistemi i fortë imunologjik do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose ta përballoni më lehtë gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht të shëndetshëm dhe keni një sistem imunologjik të fortë, prapëseprapë mund të sëmureni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripin?

Ndiqu këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë ose në vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë ndërsa jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një pecetë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidhni ato në plehra.
- Mbani maskë mbrojtëse kur kontaktoni me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagta që përmbajnë alkool ose dezinfektues për pastrimin e duarve.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën ku qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbajeni mjedisin tuaj të pastër - objekte, sipërfaqe, me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjet ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkoni ndihmë mjekësore.

KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje graduale e numrit dhe incidencës të sëmundjeve të ngjashme me gripin, por kjo mbetet në nivel messezonal, që është karakteristike për këtë periudhë të vitit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

- ❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritete të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 75.115 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vakcina falas.**

- ❖ 2.400 vakcina komerciale shitesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vakcina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.894 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 77.009 persona me kasina falas dhe vakcina komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e 46 të vitit 2025:

Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 6 nga 32 vendet rajonit evropian të OBSH-së që raportojnë.

Gjatë javës së 45 për herë të parë është raportuar pozitivitet mbi 10%, që e shënon fillimin e sezonit të gripit në Rajonin Evropian. Aktiviteti i virusit në rajon dallon, ndërkohë që është regjistruar një aktivitet më i lartë në pjesën perëndimore të Rajonit Evropian.

Tek rastet e hospitalizuara gjithashtu është detektuar një rritje e rasteve me grip, ndërsa më e prekur është grupmosha mbi 65 vjet. Në të shumtën e rasteve është raportuar Influenza A(H3).

Indikatorët për aktivitetin e SARS-CoV-2 po zvogëlohen, por me një variacion në mes vendeve.
Indikatorët për aktivitetin e gripit dhe RSV mbeten në nivel rajonal, por më e prekur është popullata e fëmijëve nën 5 vjet.

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik